

VENDIM
Nr. 86, datë 9.6.2016

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SHPK PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË LICENCËS NR. 49, SERIA NPM07 “PËR NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE ELEKTRIKE (PROJEKTI KAPPET)”, TË DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s ME NR. 61, DATË 2.11.2007, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të elektrike”, nenit 5 dhe 6, të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, neneve 16, pika 2 dhe 18, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, gjerat “a”, “d”, “e”, të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007 të Bordit të ERE-s, pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7 të kushteve të licencës nr. 49, seria NPM07P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale elektrike (Projekti Kappet)”, të dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “Hera” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “Hera” sh.p.k., në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 56, datë 25.8.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 136, datë 15.11.2013.

- Me shkresën me nr. 89 prot., datë 22.10.2014, shoqëria “HERA” sh.p.k., ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 24 muaj të afateve të licencës së ndërtimit të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 61, datë 25.11.2007, i ndryshuar, së fundmi me vendimin nr. 136, datë 15.11.2013.

- Mospërmbushja e pikës 4, të vendimit nr. 61, datë 25.11.2007, i ndryshuar, e bën licencën të pavlefshme.

- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE, me iniciativën e vet mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të licencës nr. 49, seria NPM07P “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale elektrike (Projekti Kappet)”, të dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 61, datë 2.11.2007, i ndryshuar.

2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k., nr. 49, seria NPM07P.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti